



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më ____ . ____ .2024

**VENDIM
Nr. 307, datë 18.06.2024**

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, PERIUDHA E VLERËSIMIT VITI
KALENDARIK 2022, PËR GJYQTARIN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61, pika 1, 63 dhe 86, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, pas verifikimit të tre kritereve të kandidimit për gjyqtarin i cili ka aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr.240, datë 24.05.2023, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}.
2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR